

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6395  
E martë, 24 gusht 2021  
çmimi 0.40 €

## Policia kufitare pajiset me 20 vetura të reja, donacion nga Gjermania

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

VAZHDON TË RRIETET NUMRI I VIKTIVAVE NGA COVID-19 NË KOSOVË

FAQE 4-5

# PËR DHJETË DITË VDIQËN 67 PERSONA NGA COVIDI



Ministria e Shëndetësisë ka bërë me dije se në 24 orët e fundit 17 persona kanë vdekur nga Covid-19. Bazuar në të dhënat e MSh-së, dy nga të vdekurit janë të grupmoshës 20-29 vjet. Përhapja e

variantit 'Delta' në vend ka ndikuar në rritjen e numrit të vdekjeve dhe të infektimeve. Vetëm në dhjetë ditët e fundit numri i të vdekurve nga Covidi në vendin tonë ka shkuar në 67

persona. Edhe Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka njoftuar për rritje të numrit të personave të hospitalizuar në klinikat Covid dhe në spitalet e përgjithshme rajonale

## AKTUALE



BREGOVIQI PERFORMON NË KORÇË NË MES TË KUNDËRSHTIMEVE

F.2

APELI E KTHEN NË RIGJYKIM RASTIN PËR KORRUPSION NDAJ PAL LEKAJT DHE TRE TË TJERËVE

F.7

NGA VITI 2019 NË SUHAREKË JANË NXJERRË MBI 4 000 DOKUMENTE NGA E-KIOSKAT

F.6



## EKONOMI

917 PUNËTORË KANË APLIKUAR PËR TË PËRFITUAR NGA PAKOJA PËR RINGJALLJE EKONOMIKE

F.8

MURATI DHE PËRFAQËSUESIT E BANKAVE KOMERCIALE DISKUTOJNË PËR PAKON E RINGJALLJES EKONOMIKE

F.8

## SPORT

MALIQI: FERONIKELI NUK DO TA KETË PROBLEM MBIJETESËN

F.8

Kërkohet dënim maksimal për vrasësit e 18 vjeçes nga Ferizaj

FAQE 3



15 577 votues nga diaspora për zgjedhjet lokale

FAQE 7

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.PK.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Greçia vazhdon përballjen me zjarret

**ATHINË, 23 GUSHT** - Dhjetëra zjarrfikës kanë luftuar me zjarret në ishullin Evia të Greçisë, të ndihmuar edhe nga aeroplanët që lëshojnë ujë. Zjarri që shpërtheu në ishullin Evia detyroi evakuimin e disa banorëve. Rreth dy javë më parë pjesa veriore e këtij ishulli ishte e shkatërruar nga flakët. Zjarri që përfshiu një pjesë të ishullit më 22 gusht po përhapej në drejtim të fshatit turistik

bregdetar Marmari. Evia është në verilindje të kryeqytetit Athinë. Autoritetet e mbrojtjes civile kishin njoftuar të dielën një "rrezik shumë të lartë" zjarri në shumë zona të Greçisë. Qeveria greke ka fajësuar për fatkeqësinë valën më të keqe të të nxehtit në dekada. Ky vend gjatë muajve të verës është përballur me temperatura të larta, nga 42 deri në 44 gradë celsius.

Që nga muaji korrik zjarret e egra kanë shkatërruar ishujt Evia dhe Rodos si dhe pyjet në veri dhe juglindje të Athinës, dhe disa pjesë të gadishullit të Peloponezitet. Si pasojë, tre persona kanë vdekur. Shkencëtarët e klimës paralajmërojnë se moti ekstrem dhe zjarret e ashpra do të bëhen gjithnjë e më të zakonshme për shkak të ngrohjes globale të krijuar nga njeriu.



## Izraeli do të ofrojë vaksinim në shkolla



**JERUSALEM, 23 GUSHT** - Izraeli ka njoftuar se do ta ofrojë mundësinë e vaksinimit nëpër shkolla pasi më parë kishte bërë me dije se mësimi me prani fizike do të vazhdojë më 1 shtator. "Nxënësit do të vaksinohen në mjediset e shkollës gjatë orarit mësimor, mirëpo vetëm nëse për imunizimin e tyre pajtohen prindërit", u tha në një deklaratë të Qeverisë së Izraelit. Autoritetet izraelite thonë se po përpiqen ta shmangin mbylljen e shkollave. Rastet e reja me koronavirus

kanë shënuar rritje në këtë vend pavarësisht një fushate disamuajshe të vaksinimit. Ministria e Shëndetësisë e Izraelit tha të hënën se janë regjistruar 6 467 raste të reja me Covid-19 dhe 1 142 persona janë të shtruar në spital. Në Izrael rreth 30 për qind e fëmijëve të moshës 12-15 vjeç kanë marrë dy doza të vaksinës. Kjo shifër është shumë më e ulët se çdo grupmoshë tjetër. Disa anëtarë të kabinetit qeveritar kishin kundërshtuar idenë e vaksinimit në shkolla. Ministria e Arsimit, Yifat

Shasha-Biton, ka thënë në muajin korrik se nxënësit mund të ndiejnë presion për të marrë vaksina.

Të hënën (23 gusht) ajo mirëpriti planin e vaksinimit duke thënë se "fillimi i vitit shkollor është thelbësor për stabilitetin dhe qëndrueshmërinë mendore të nxënësve".

Vala e re e të infektuarve e ka detyruar qeverinë të miratojë masa të reja kufizimi si dhe të lejojë një dozë të tretë të vaksinës për njerëzit e moshës 40 vjeç e lart.

## Erdogani viziton Bosnjën më 27 gusht

**ANKARA, 23 GUSHT** - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, do ta vizitojë Bosnje e Hercegovinën më 27 gusht, konfirmoi për Shërbimin e Ballkanit të "Radios Evropa e Lirë", Presidenca e Bosnjës.

Takimi me anëtarët e Presidencës së këtij vendi është planifikuar për të njëjtën ditë. Anëtarët e Presidencës: Zhelko Komshiq, Shefik Xhaferović dhe Millorad Dodik janë takuar me presidentin turk në Ankara në mes të marsit, kur edhe është nënshkruar Marrëveshja për ndërtimin e autostradës Sarajevë - Beograd.

Në fillim të majit në Bosnje ka qëndruar edhe ministri i Punëve të Jashtme i Turqisë, Mevlut Cavushoglu, i cili është takuar me



tre anëtarët e Presidencës së Bosnjës. Atëbotë Cavushoglu ka thënë se Turqia do të punojë për ta thelluar bashkëpunimin ekonomik dhe për t'i rritur investimet turke në Bosnje.

Presidenti turk ka qëndruar për herë të fundit në Bosnje në korrik të vitit 2019, kur ka marrë pjesë në Samitin e Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore.

## 'Pfizer/BioNTech' merr miratimin e plotë nga FDA-ja

**NJU-JORK, 23 GUSHT** - Administrata amerikane e Ushqimit dhe Barnave (FDA) i dha të hënën miratimin e plotë vaksinës "Pfizer/BioNTech" kundër koronavirusit. Vaksina, e krijuar nga kompania amerikane "Pfizer" dhe ajo gjermane "BioNTech", është miratuar për përdorim emergjent qysh në dhjetor.

Që atëherë, mbi 204 milionë njerëz vetëm në ShBA e kanë marrë atë.

Kjo është vaksina e parë që merr miratimin e plotë nga FDA-ja për përdorim te personat mbi 16 vjeç. ShBA-ja ka miratuar për përdorim emergjent edhe dy



vaksina të tjera: "Moderna" dhe "Johnson&Johnson".

Zyrtarët e shëndetit publik shpresojnë se vendimi i fundit i FDA-së do t'i bindë shumë amerikanë të pavaksinuar se vaksina "Pfizer/BioNTech" është e sigurt dhe efektive. Vaksina "Pfizer/BioNTech" jepet edhe në Kosovë, ashtu si edhe vaksina e kompanisë anglo-suedeze "AstraZeneca".


## Bregoviqi performon në Korçë në mes të kundërshtimeve

**KORÇË, 23 GUSHT** - Nën sigurinë e shumë forcave policore, muzikanti Goran Bregoviç ka performuar më 22 gusht në Festën e Birës në Korçë. Gjatë koncertit u hodh gaz lotsjellës dhe disa persona u shoqëruan në polici. Pjesëmarrja e

Bregoviçit në koncert ishte kundërshtuar paraprakisht në Kosovë dhe Shqipëri. Bregoviç e nisi koncertin me këngën në gjuhën shqipe "Kosovska" (e Kosovës) të bendit "Bijelo Dugme" dhe duke e përfunduar me këngën

"Kallashnikov", këngë që cilësohet se "zgjoi nacionalizmin serb" dhe nxitu ushtarët serbë të shkaktojnë masakra në Kosovë dhe Bosnje e Hercegovinë. Goran Bregoviç është ish-frontman i grupit "Bijelo Dugme", një nga grupet më të

njohura të rokut në ish-Jugosllavi. Ai u lind në Sarajevë më 1950. Babai i tij ishte kroat dhe nëna serbe, kurse gruaja e tij është boshnjake. Bregoviç vetë nuk është shprehur publikisht mbi luftërat në ish-Jugosllavi. "Qëndrimi neutral" thonë se



ishite arsyeja për të cilin publiku e dënon.

# Kërkohet dënim maksimal për vrasësit e 18-vjeçares nga Ferizaj

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 GUSHT - Dita e diel ishte e kobshme për një vajzë 18 vjeçe e cila u la pa shenja jete në Qendrën Emergjente të Ferizajt. Policia e Kosovës e ka cilësuar rastin "Vrasje e rëndë" dhe deri më tani është arrestuar një i dyshuar, kurse i dyshuari i dytë gjendet në arrati.

Drejtoria Rajonale e Policisë në Ferizaj ka kërkuar bashkëpunim nga qytetarët për identifikimin dhe vendndodhjen e personit në kërkim policor, i cili dyshohet për "Vrasje të rëndë". "I njëjti, i dyshuar, deri më tani nuk është paraqitur në polici dhe është në arrati. Personi i kërkuar është Dardan (Emrush) Krivaqa, i lindur më 25.08.1992, adresa: rr. 'Ramadan Rexhepi', kati V, nr. 3, Ferizaj. Policia kërkon nga qytetarët që kushdo që ka ndonjë informacion rreth këtij personi dhe vendndodhjes së tij, ta lajmërojë policinë, stacionin më të afërt, apo përmes aplikacionit digjital 'Lajmëro policinë' dhe në numrat kujdestarë: 192, 0290/326-250 & 0290/322-406. Të

dhënat e juaja do të ruhen në konfidencialitet të plotë", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) përmes një reagimi ka theksuar se ky rast na shpërfaq edhe një herë mangësitë institucionale në trajtimin me seriozitet të vrasjeve ndaj grave dhe të femicidit. "Vrasja e kësaj vajze assesi nuk është rast i izoluar e as ndodhi rastësore. Kjo vajzë vdiq në një vend në të cilin çdo vrasje e grave shoqërohet me heshtje institucionale, me zvarritje të hetimeve dhe me dënime të ulëta për vrasësit e grave. Si për secilën vrasje të grave nga burrat këtu kemi një zinxhir fajtorësh brenda institucioneve. Si ka mundësi që në një institucion shëndetësor të lihet trupi i pajetë i një gruaje, pa kurrfarë llogaridhënie? Le të kujtojmë këtu se spitalet e kanë obligim që në të gjitha rastet ku ka shenja të dhunës të lajmërojnë institucionet e sigurisë e të sigurohen që ushtruesit e dhunës të mos ikin", është theksuar në këtë reagim.

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) kërkon që hetimi i vrasjes së 18-vjeçares të jetë prioritet për

organet e hetuesisë si dhe fajtorët ta marrin dënimin maksimal. Po ashtu, përmes kësaj këtij reagimi RrGK-ja ka njoftuar se do ta përcjellë rastin nga afër dhe do të kërkojë vënie të drejtësisë në vend. "Njëherësh, u bëjmë thirrje qytetarëve që të bashkëpunojnë për gjetjen e të dyshuarit të dytë, kurse mediave u bëjmë thirrje që të raportojnë duke pasur në qendër të vëmendjes ruajtjen e dinjitetit të viktimës, sepse vetëm në këtë mënyrë secili prej nesh do të luajmë rolin që na takon në luftimin e pakusht të vrasjes së vajzave dhe grave. RrGK nuk do të ndalet derisa vrasjet e vajzave dhe grave të mos trajtohet vetëm si lajm ditor apo si çështje private", është theksuar në reagimin e RrGK-së. Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka thënë se dhuna e këtyre përmasave është alarm që duhet t'i mobilizojë institucionet e policisë, prokurorisë dhe gjykatave, t'i trajtojnë me prioritet e me seriozitetin maksimal rastet e tilla, kurse dhunuesit të vihen përballë drejtësisë. "Inkurajimit

të qytetarëve për të raportuar dhunën, duhet t'i përgjigjemi me veprime konkrete, për gjetjen e dhunuesve dhe sjelljen e tyre përpara drejtësisë. Është e domosdoshme të veprojmë, pa vonesa, e me përkushtim maksimal. Cenimi i lirisë, qoftë përmes ngacmimeve seksuale, shantazheve e deri te dhuna ndaj grave apo kujtdo tjetër, është e papranueshme dhe si e tillë duhet të trajtohet, pa kompromis ndaj dhunës, e me dënimin e merituar ndaj dhunuesve. Ky fenomen duhet të luftohet pareshtur. Dhuna nuk mund të normalizohet, si rrjedhojë duhet të dënohet ashpër", ka thënë Haxhiu.

Edhe presidentja e vendit, Vjosa Osmani, ka reaguar për vrasjen e 18 vjeçes. Ajo ka thënë se vetëm drejtësia e dënimi për ata që po i kryejnë këto krime makabre ndaj grave e vajzave të Kosovës mund të ndryshojë situatën e trishtë të pabarazisë me të cilën përballemi sot në Kosovë. "Ne nuk mund të heshtim apo të vazhdojmë të lejojmë trajtimin e këtyre rasteve si çështje familjare. Jemi dëshmitarë të

vrasjeve si rezultat i shmangies të dhunuesve nga ligji, ndaj kjo situatë duhet të marrë fund. Si presidente e vendit i bëj thirrje secilit qytetar që të bashkëpunojë me organet e rendit dhe ligjit për gjetjen e vrasësit të viktimës nga Ferizaj. U bëj thirrje të gjitha institucioneve përgjegjëse që të punojnë fort dhe pandërprerë derisa kryesit e veprave të tilla të gjenden prapa grilave", ka thënë Osmani.

Ajo ka theksuar se dhuna ndaj vajzave e grave kërcënon paqen për të gjithë dhe mirëqenien e përgjithshme. Sipas Osmanit, shoqëria jonë duhet të jetë e palëkundur dhe e vendosur për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit e dhunës ndaj vajzave e grave. "Familjarëve, miqve dhe gjithë shoqërisë së vajzës së ndjerë u shpreh ngushëllime të sigjerta! Shpirti i saj do të pushojë në paqe atëherë kur të ketë drejtësi. Drejtësinë ia kemi borxh secilës vajze e gruaje që përjetoj dhunën nga ata që po marrin jetë e po i ikin përgjegjësisë", ka deklaruar presidentja Osmani.



## 15 577 votues nga diaspora për zgjedhjet lokale

Prishtinë, 23 gusht - 15 577 aplikues kanë arritur të regjistrohen suksesshëm jashtë Kosovës, ndërsa 3 259 të tjerë jo, pasi nuk kanë plotësuar kriteret juridike. Këto të dhëna janë

bërë me dije për 'Ekonomia Online' nga zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi. Shifrat e prezantuara nga KQZ-ja janë shumëfish më të ulëta krahasuar me zgjedhjet e

parakohshme parlamentare të para disa muajve. Për zgjedhjet e 14 shkurtit ishin regjistruar më shumë se 102 mijë votues nga jashtë vendit edhe pse koha ishte shumë e shkurtër.

Zëdhënësi i KQZ-së ka bërë me dije se gjatë periudhës 40 ditore në total KQZ-ja ka pranuar 18 836 aplikacione për regjistrim, por që jo të gjithë kanë plotësuar kriteret juridike.





VAZHDON TË RRIETET NUMRI I VIKTIMAVE NGA COVID-19 NË KOSOVË

## Për dhjetë ditë vdiqën 67 persona nga Covidi

Ministria e Shëndetësisë ka bërë me dije se në 24 orët e fundit 17 persona kanë vdekur nga Covid-19. Bazuar në të dhënat e MSh-së, dy nga të vdekurit janë të grupmoshës 20-29 vjet. Përhapja e variantit 'Delta' në vend ka ndikuar në rritjen e numrit të vdekjeve dhe të infektimeve. Vetëm në dhjetë ditët e fundit numri i vdekurve nga Covidi në vendin tonë ka shkuar në 67 persona. Edhe Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka njoftuar për rritje të numrit të personave të hospitalizuar në klinikat Covid dhe në spitalet e përgjithshme rajonale

**EPOKA  
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 23 GUSHT - Bilanci i viktimave nga Covid-19 në Kosovë është rënduar të hënën. Ministria e Shëndetësisë ka treguar se në 24 orët e fundit nga Covid-19 kanë vdekur 17 persona. Bazuar në të dhënat e MSh-së, dy nga të vdekurit janë të grupmoshës 20-29 vjet, një i grupmoshës 40-49 vjeç, tre të grupmoshës 50-59 vjeç, pesë të grupmoshës 60-69 vjeç, katër të grupmoshës 70-79 vjeç dhe dy të grupmoshës mbi 80 vjeç.

Grupmosha 20-29 vjeç dominon edhe me raste të reja të infeksionit, pasi janë regjistruar 267 sosh, më pas vjen grupmosha 30-39 vjeç me 209 raste të reja pozitive dhe ajo 40-49 vjeç me 191 raste pozitive. Në grupmoshën 10-19 vjeç janë regjistruar 112 raste pozitive, ndërsa në atë 0 deri 9 vjeç, 16 raste. "Prej 7 946 testimeve, 1 067 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar 17 raste të vdekjes. Sot janë shëruar 278 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve

është 107 566. Në total numri i rasteve aktive është 20 467", është thënë në njoftimin e MSh-së.

Rritja e rasteve të vdekjes ka nxitur reagimin e ish-ministrit të Shëndetësisë, Armend Zemaj, duke kërkuar përgjegjësi nga kryeministri Albin Kurti. "Kryeministër dhe ministër 'rekordzi', ku jeni? Gjendje alarmante! Për dhjetë ditë kemi 17 723 raste të reja me Covid-19. Po ashtu, 67 qytetarë kanë humbur jetën në të njëjtën periudhë kohore, ndërkaq vetëm sot 17 prej tyre. Ndërsa, raste aktive kemi 20 467", ka shkruar Zemaj në

profilin e vet në "Facebook".

Ai ka thënë se qeveria aktuale po i sheh qytetarët vetëm si numra. "Kryeministër dhe ministër 'rekordi'. Krejt padrejtësisht qytetarët po i shihni si numra për vota, ndaj dhe e kemi këtë gjendje të vështirë. Mos harroni se po thyni çdo rekord të zi të cilin vetë e keni arritur. Mundohuni ta kuptoni një herë e mirë se qytetarët po i shndërroni në pacientë të shumtë nga dija juaj e paktë. Qytetarët kanë nevojë për kujdes, mbikëqyrje dhe ndihmë. Ata, familjarët e tyre dhe të gjithë meritojnë të jetojnë shëndetshëm. Po shihet se menaxhimi i pandemisë nga ju ka qenë një frazë populiste dhe as që ka ekzistuar, ndaj dhe gjendja në tërësi ka degraduar", ka shkruar ish-ministri Zemaj. Sipas tij, dorëheqja e parevokueshme e ministrit të Shëndetësisë, si pasojë e dështimit në menaxhimin e pandemisë Covid-19, është

obligim dhe përgjegjësi.

Edhe Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka njoftuar për rritje të numrit të personave të hospitalizuar.

Brenda 24 orëve të fundit ShSKUK-ja ka treguar se 929 pacientë janë të shtrirë në klinikat Covid dhe në spitalet e përgjithshme. "723 të konfirmuar Covid-19 pozitivë, 688 janë me oksigjeno-terapi dhe 35 pacientë janë në gjendje të rënduar shëndetësore", është bërë me dije në njoftimin e ShSKUK-së.

**Vazhdojnë thirrjet për qytetarët që të vaksinohen**

Si pasojë e përhapjes së variantit "Delta" është shtuar numri i infektimeve dhe vdekjeve. Në këtë kohë nuk kanë munguar thirrjet e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare për qytetarët

që të vaksinohen. Të hënën edhe Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovës u ka bërë thirrje qytetarëve që të vaksinohen kundër Covid-19. Kjo ambasadë ka treguar se përmes mekanizmit "Covax" Kosova do të furnizohet me mbi 700 mijë vaksina. "Kjo dhuratë nga populli amerikan është donacioni më i madh i vetëm i vaksinave në Kosovë nga çdo vend apo organizatë. Kur të përfundojë donacioni amerikan do të sjellë në mbi 700 000 numrin e dozave të dorëzuara përmes mekanizmit 'Covax'. Më shumë vaksina janë në rrugë, por vaksinat funksionojnë vetëm nëse individët vaksinohen. Pra, ju lutemi, vaksinoheni për ta mbrojtur veten, familjet tuaja dhe komunitetet tuaja. Së bashku ne mund të mposhtim Covid-19", është thënë në mesazhin e Ambasadës së

ShBA-së në Prishtinë.

Edhe ish-ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka ftuar qytetarët që të vaksinohen. "Të dashur qytetarë, ju lutem, kurdo që t'ju vijë mundësia e parë, vaksinohuni. Uroj që të gjithë t'i respektojmë rekomandimet e IKShPK-së. Mbani maskat! Respektoni distancën! Mbani higjienën", ka qenë mesazhi i Zemajt.

Kohën e fundit është shtuar edhe numri i qytetarëve që po vaksinohen.

Vetëm të shtunën 18 776 qytetarë kanë marrë vaksinën kundër Covidit.

Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 707 793 doza të vaksinës, ndërsa 236 405 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.

Ndonëse numri i rasteve të vdekjeve është shtuar ditët e fundit, një ditë më parë Instituti i Shëndetësisë Publike

të Kosovëska deklaruar se i është ndalur turri variantit 'Delta' të koronavirusit. "Delta' variantit ia kemi ndalë turrit edhe pse akoma po raportohen shumë raste pozitive dhe shumë vdekje duke shprehur ngushëllime për të gjithë familjarët! Virusi bartet shumë shpejt prej një personi në dhjetëra persona të tjerë me pasoja që në të shumtën e rasteve mund të jenë fatale e që, fatkeqësisht, preken edhe fëmijët. Andaj, ju lutemi, të zbatoni masat e rekomanduara nga IKShPK-ja. Vetëm së bashku do ta rrafshojmë lakoren epidemike dhe do ta ndalim tërbimin e virusit SARS CoV-2", është thënë në njoftimin për media të IKShPK-së.

Prej 13 marsit 2020, kur janë regjistruar rastet e para të infektimit, autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë regjistruar mbi 126 mijë pacientë me këtë virus. Prej

## FSK-ja shpërndan maska për qytetarët

PRISHTINË, 23 GUSHT - Me qëllim vetëdijesimi dhe mbrojtje nga Covid-19, Forca e Sigurisë e Kosovës (FSK) është duke ndihmuar qytetarët në të gjithë vendin për përballimin e situatës me pandeminë. FSK-ja të hënën ka filluar operacionin e shpërndarjes së materialeve mbrojtëse kundër Covidit në të gjitha komunat. Këto materiale mbrojtëse kundër Covid-19 i janë dhuruar donacion FSK-së nga qeveria gjermane.



## Spitalet plot, ndërpriten shërbimet jourgjente



PRISHTINË, 23 GUSHT - Situata e rënduar me Covid-19 ka shtyrë Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK) të pushojë dhënien e disa shërbimeve spitalore jourgjente në sallat kirurgjike. Operacionet të cilat mund të

kryhen, sipas SHSKUK-së, janë ato të karakterit urgjent dhe emergjent, por edhe tumore.

Drejtori i SHSKUK-së, Valbon Krasniqi, ka bërë me dije për "Radion Evropa e Lirë" se nga data 23 gusht, përveç

pushimit të dhënies së disa shërbimeve mjekësore jourgjente, janë ndërprerë edhe pushimet vjetore të stafit shëndetësor. "U kërkoj falje punëtorëve shëndetësorë që jemi detyruar t'i ndërpresim pushimet dhe u kërkoj

mirëkuptim edhe qytetarëve dhe pacientëve për këto reduktime në shërbime të tjera, por kjo është situatë është e imponuar dhe jemi të shtrënguar të marrim këso vendime", tha Krasniqi. Kosova nuk ka spital të

veçantë ku trajtohen pacientët me Covid-19. Për këtë, shtoi Krasniqi, po detyrohen të marrin shtretër të pacientëve të tjerë për t'i shtrirë pacientët nga Covid-19. Ai tha se situata epidemiologjike në Kosovë është mjaft e rënduar.

## Zbulohet pllaka përkujtimore te kulla e Man Karaqicës

**DRENAS, 23 GUSHT (ER)** - Kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka marrë pjesë në zbulimin e pllakës përkujtimore në

fshatin Gllanasellë, ku është vendosur te kulla e Man Karaqicës. Me rastin e përvitshorit të kësaj pllake, kryetari Lladrovci ka

vendosur edhe buqeta me lule. Lladrovci ka marrë pjesë edhe në njëvjetorin e vdekjes së veteranit të Ushtrisë Çlirimtare të

Kosovës, Qamil Demiri nga fshati Nekoc, ku edhe ka vendosur buqeta me lule pranë varrit të tij dhe ka mbajtur një fjalim rasti.



## Haziri: Prioritet në Gjilan është imunizimi kolektiv i popullatës përmes vaksinimit

**GJILAN, 23 GUSHT (ER)** - Kryetari i komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, pas mbledhjes së Komitetit për menaxhimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19, në bazë të analizimit të gjendjes në 24 orët e fundit, u ka bërë thirrje qytetarëve për kujdes maksimal, vetizolim për të gjithë të infektuarit, njëkohësisht përgjigje në fushatën e vaksinimit. Gjatë adresimit në konferencën për media të së hënës, kryetari Haziri ka bërë me dije se gjatë 24 orëve të fundit janë regjistruar katër vdekje, që është numri më i madh deri më tani i regjistruar brenda një dite, ku edhe u ka shprehur ngushëllim familjeve që i humbën më të dashurit e tyre. “Gjendja po vazhdon të jetë jashtëzakonisht e rënduar, me numër të madh të të infektuarve që ka arritur në 1 412 qytetarë të Gjilanit që janë të prekur. Të infektuarit lutem që të vetizolohen dhe të vetëpërbahen nga dalja jashtë shtëpisë apo edhe kontaktit me

anëtarët e tjerë të familjes që të mos e bartin infeksionin. Policia e Kosovës dhe inspektorët e komunës së Gjilanit do të kujdesen për zbatimin e protokollit për të gjithë të infektuarit, prandaj ju lusim që të qëndroni në shtëpi. Gjendja në Spitalin e Përgjithshëm është rënduar. Tani atje gjenden 97 pacientë nën kujdesin e vazhdueshëm të mjekëve. Koordinimi me institucionet private të shëndetësisë do të jetë më i madh për monitorimin e gjendjes në bashkëpunim me institucionet e rendit”, ka thënë Haziri.

Ai, po ashtu, ka bërë me dije se komuna e Gjilanit është duke bërë të gjitha përgatitjet edhe për fillimin e procesit të mësimin dhe monitorimin e personelit arsimor nëse është vaksinuar apo jo, në të kundërtën, sipas tij, pa dëshminë për vaksinim ose pa test të përditshëm kundër Covidit, nuk tolerohet që mësimdhënësi të dalë para nxënësve.



## Nga viti 2019 në Suharekë janë nxjerrë mbi 4 000 dokumente nga E-kioskat

**SUHAREKË, 23 GUSHT (ER)** - Kryetari i komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka bërë me dije se nga viti 2019 në Suharekë janë vënë në funksion E-kioskat 24/7, në shërbim të qytetarëve për dokumente të gjendjes civile, si certifikata të lindjes, ekstrakt etj. “Që nga ajo periudhë në E-1 janë nxjerrë 3 706 dokumente të ndryshme nga qytetarët, ndërsa në E-2 janë nxjerrë 483. Ky është sukses i veçantë në shërbimet tona

administrative”, ka thënë Muharremaj. Ai ka theksuar se në dy pika të qytetit, njëra afër Qendrës për Prodhimin e Dokumenteve (pasaportave) dhe tjetra afër Qendrës për Punë Sociale, vazhdojnë të mbeten aktive për shërbimet ndaj qytetarëve. Muharremaj ka thënë se E-kioskat pranojnë monedha metalike dhe do të kthejnë kusur sipas diferencës së çmimit dhe monedhave të futura në E-kiosk.



## Vazhdojnë punimet për ndërtimin e shkollës profesionale në Kamenicë

**Kamenicë, 23 gusht (ER)** - Janë duke vazhduar punimet për ndërtimin e Shkollës Profesionale në Kamenicë e cila arrin vlerën

mbi 410 mijë euro. I pari i komunës, Qëndron Kastrati, ka thënë se projektet në komunën e Kamenicës janë duke vazhduar dhe puna

nuk do të ndalet. “Kjo shkollë ka vlerën mbi 410 mijë euro. Vazhdojmë punën”, ka thënë Kastrati. Realizimi i këtij projekti u

mundësua nga organizata “Qëndresa Kosovare” përmes donatorit nga Kuvajti si dhe komunës së Kamenicës.



# Policia kufitare pajiset me 20 vetura të reja, donacion nga Gjermania

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 GUSHT - Gjermania ia ka dhuruar Kosovës 20 vetura të reja, të cilat do të shërbejnë në të gjitha pikat kufitare anekënd vendit. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti, ka thënë se veturat e reja të cilat do të përdoren për patrullimet në pikat kufitare do të shërbejnë për luftimin e

trafikimit të armëve, mallrave, narkotikëve dhe në luftën kundër migracionit të parregullt. "Ky është kontingjenti i dytë i automjeteve që kanë ardhur ndihmë për policinë kufitare nga qeveria gjermane. Shfrytëzoj rastin që të falënderojmë ambasadën gjermane dhe qeverinë gjermane për ndihmën që ka dhënë për policinë kufitare dhe policinë në përgjithësi. Këto automjete do të përdoren

kryesisht për luftën kundër trafikut të armëve, trafikut të ndryshëm, qoftë të armëve, të narkotikëve, të mallrave dhe, natyrisht, në luftën kundër migracionit të parregullt. Të gjitha këto mjete dedikohen kryesisht për policinë kufitare dhe do të jenë në përdorim në patrullim në vijën e gjelbër dhe në patrullimet kufitare anekënd Kosovës", ka deklaruar Mehmeti. Kurse ambasadori gjerman në

Kosovë, Joern Rohde, ka pohuar se ky donacion dëshmon bashkëpunimin e mirë që kanë dy institucionet përkatëse të sigurisë. Ai ka theksuar se një bashkëpunim i tillë do të vazhdojë edhe për ngritjen e kapaciteteve të tjera. Rohde ka thënë se me këtë donacion do të rritet prania e policisë në pikat kufitare e, si rrjedhojë, edhe kapacitetet e saj. "Jam shumë i lumtur që për

herën e dytë po bëjmë shpërndarjen e donacionit të dytë të 20 veturave të modelit 'Dacia' prej policisë federale gjermane. Ky donacion dëshmon bashkëpunimin që kemi ndërmjet institucioneve tona policore. Mendojmë se me donacionin e dytë do të ngrihen kapacitetet dhe prania policore në pikat kufitare", ka thënë ambasadori gjerman Joern Rohde.



## Apeli e kthen në rigjykim rastin për korrupsion ndaj Pal Lekajt dhe tre të tjerëve



PRISHTINË, 23 GUSHT - Gjykata e Apelit e ka kthyer në rigjykim rastin ndaj ish-kryetarit të komunës së Gjakovës, Pal Lekaj, i cili në shkurt të këtij viti ishte dënuar me 1 vit e 6 muaj burgim

me kusht nga Gjykata Themelore në Gjakovë, nën akuzën se ka keqpërdorur detyrën zyrtare gjatë kohës sa ka qenë në krye të komunës në fjalë. Në rigjykim është kthyer

edhe pjesa ndaj ish-zyrtarëve të tjerë të kësaj komune, Gani Rama dhe Ismet Isufi. I akuzuari Rama ishte dënuar me 1 vit burgim me kusht, ndërsa i akuzuar Isufi ishte dënuar me 1

vit e 6 muaj burgim me kusht. Po ashtu, rasti është kthyer në rigjykim edhe ndaj të akuzuarit për mashtrim me subvencione, Veli Hajdaraga. (Betimi për Drejtësi)

## Në Klinikën e Pediatriisë fillojnë shërbimet e hemodializës për fëmijët

PRISHTINË, 23 GUSHT (ER) - Pas tre vjetësh, Klinika e Pediatriisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës ka filluar të ofrojë sërish shërbime të

hemodializës për fëmijët e moshës 0-5 vjeçe. Në mungesë të materialit shpenzues, ky shërbim ishte ndërprerë në vitin 2018. Menaxhmenti i

SHSKUK-së është angazhuar që të gjejë një zgjidhje të shpejtë dhe të qëndrueshme për furnizim me material harxhues, në mënyrë që në Hemodializë,

pas një kohe të gjatë, të kthehet shërbimi i munguar. Shërbimi i Hemodializës në Klinikën e Pediatriisë është hapur në vitin 2014.



# Murati dhe përfaqësuesit e bankave komerciale diskutojnë për pakon e ringjalljes ekonomike



**PRISHTINË, 23 GUSHT (ER)** - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka pritur të hënën në takim guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës dhe menaxhmentin e lartë të bankave komerciale për të diskutuar lidhur me operacionalizimin e dy masave të pakos së ringjalljes ekonomike, gjeqsisht masës 2.1

(Subvencionimi i kredive investive) dhe masës 3.6 (Mbështetja e likuiditetit familjar). Këto masa kanë për qëllim kreditimin e bizneseve prodhuese si dhe mbështetjen e likuiditetit familjar, si faktorë që ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen ekonomike dhe rritjen e mirëqenies së qytetarëve.

Ministri Murati gjatë takimit ka

thënë se masa 2.1 (Subvencionimi i kredive investive) synon rritjen e investimeve të reja në kapacitete prodhuese dhe përpunuese, të cilat rritin punësimin dhe ndikojnë në zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. "Krahas bizneseve prodhuese, duke konsideruar rëndësinë e veçantë të fuqizimit të grave në ekonomi, e njëjta masë aplikohet edhe për

bizneset joprodhuese të udhëhequra nga gratë. Përkatesisht, me anë të kësaj mase qeveria do t'i mbështesë kreditë për bizneset prodhuese dhe ato në pronësi të grave për ta financuar zgjerimin e kapaciteteve, duke subvencionuar deri në 20 për qind të kryegjësë së kredisë, më saktësisht 10 për qind të kryegjësë në fillim, si dhe 10 për qind të tjera

në fund të kredisë në rast se janë përbushur objektivat e investimit", ka thënë ai.

Në anën tjetër, Murati ka thënë se masa 3.6 (Mbështetja e likuiditetit familjar) ka për qëllim kreditimin e amvisërisë deri në 3 000 euro, që do t'u mundësojë shumë familjeve ta kenë më të lehtë përballimin e shpenzimeve sezonale.

Si rezultat i takimit, palët u pajtuan se do ta vazhdojnë bashkëpunimin për implementimin e masave nga Pakoja e Ringjalljes Ekonomike, duke kaluar në fazën teknike të operacionalizimit të masave 2.1 dhe 3.6. Pakoja e Ringjalljes Ekonomike, e shpallur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ndër të tjera, favorizon bindshëm bizneset prodhuese si një ndër aktorët me rëndësi të zhvillimit ekonomik të vendit. Pakoja, gjithashtu, ka fokus të veçantë krijimin e një shoqërie të barabartë dhe ngritjen e mirëqenies së qytetarëve.

## 917 punëtorë kanë aplikuar për të përfituar nga pakoja për ringjallje ekonomike

**EPOKA E RE**


**Qendresa RAMA**

**PRISHTINË, 23 GUSHT** - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar se deri më tani kanë aplikuar 344 biznese për 917 punëtorë për të përfituar nga pakoja për ringjallje ekonomike. "Sipas statistikave, vërehet se numri më i madh i punëtorëve që kanë aplikuar është për masën 1.3, mbështetja e punësimit të grave, për të cilën do të bëhet subvencionim i pagës deri në 50 për qind të pagës bruto mujore për tre muaj, ndërsa pas

përfundimit të periudhës tremujore subvencionohen kontributet pensionale për muajt e mbetur, konform kriterëve dhe kufizimeve të përcaktuara me vendimin për zbatimin e masës 1.2 të Pakos së Ringjalljes Ekonomike të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve nr. 40/2021, të datës 29 korrik 2021", ka njoftuar ATK-ja.

Sipas këtij njoftimi, për masën 1.1 rikthimi në punë i atyre që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë, do të bëhet subvencionim i pagës deri në 50

për qind të pagës mujore bruto për tre muaj (maksimum deri në 170 euro bruto), si dhe masa 1.2 mbështetja për të punësuarit e formalizuar, do të bëhet subvencionim i kontributit pensional në vlerë prej 10-përqindësh të pagës bruto mujore për më së shumti 12 muaj, duke filluar nga muaji korrik 2021 deri në muajin qershor 2022", ka njoftuar ATK-ja. Të drejtë aplikimi kanë shoqëritë tregtare të regjistruara dhe punëdhënësit sipas legjislacionit të Kosovës. Aplikimi është i hapur deri më 15 tetor.



## Rriten çmimet e konsumit ditor në Kosovë

Prishtinë, 23 gusht - Mursel Gashi, banor i Prishtinës, është i shqetësuar me rritjen e çmimeve të konsumit të përditshëm në Kosovë. Derisa blinte në një nga tregjet e kryeqytetit, ai tha se çmimet janë vështirë të përballeshme, posaçërisht për ata me të ardhura më të vogla siç janë pensionistët. "Çdo ditë çmimet vetëm po shkojnë më lart, nuk ka kontroll, nuk janë të interesuar as inspektorët e as shteti. Këta po i ngrehin çmimet sipas dëshirës së vet", ka thënë ai për "Zërin e Amerikës".

Ibish Asllani nga Agjencia e Statistikave të Kosovës ka theksuar, në një bisedë për "Zërin e Amerikës", se muaji



korrik i këtij viti ka shënuar ngritje të çmimeve për 0.8 për qind krahasuar me muajin

qershor, ndërsa çmimet janë rritur për 3.5 për qind në krahasim me muajin korrik të

vitet të kaluar. "Për këta që i kanë milionat është lirë, ndërsa për ne me pensione e me ndihma është

vështirë shumë, por nuk po kemi çfarë të bëjmë", ka thënë një tjetër qytetar i Prishtinës.

Dardan Abazi nga Instituti për Politika Zhvillimore - INDEP ka theksuar se pandemia dhe marrëveshjet e paligjshme ndërmjet tregtarëve janë disa nga shkaqet e ngritjes së çmimeve në vend. "Ne konsiderojmë se mungon një kapacitet institucional për të mbikëqyruar konkurrencën në treg, sidomos te rastet që ka shumë industri të caktuara të cilat po bëjnë marrëveshje të ndaluara për rritje të organizuara të çmimeve, gjë që është e ndaluar me ligj", ka deklaruar Abazi.



# Fuqia e fjalëve: Çfarë kanë të përbashkëta fjalimet e mëdha të Kingut, Kennedyt dhe Obamas?



Dy nga retorikët më të mëdhenj të historisë amerikane – Martin Luther King, Jr dhe Robert F. Kennedy – u vranë 53 vjet më parë. Fjalët e tyre rezonojnë edhe sot, shkruan Benjamin Ramm.

Më 4 prill 1968, në ditën e vrasjes së Martin Luther Kingut, Robert F. Kennedy po bënte fushatë në Indiana për nominimin e demokratëve. Ai u njoftua për vdekjen e Dr. Kingut tek aterroi në Indianapolis, ku synonte të sigurote mbështetje. Në vend të kësaj, Kennedy mbajti një eulogji të jashtëzakonshme, nga traumat e tij personale – vrasjen e vëllait të tij pesë vjet më parë – dhe shkrimtarët klasikë që ndihmuan formimin e tij.

“Poeti im i preferuar është Eskili”, i tha Kennedy publikut, duke cituar një version të përkthimit të Agamemnonit të vitit 1930 nga Edith Hamilton: “Në gjumin tonë/ dhimbja që nuk harron/ bie pikë pas pike në zemër/ derisa, me vet dëshpërimin tonë/ kundër vullnetit tonë/ vjen mençuria/ nëpërmjet hirit të tmerrshëm të Perëndisë!”

Kennedy në të vërtetë e ngatërroi pak tekstin, duke zëvendësuar “pavarësisht” me “dëshpërim”. Siç ka shkruar Christopher S. Morrissey, është e vështirë të

dihet “nëse ai gaboi qëllimisht, rastësisht ose pa dashje”, por fjalët e tij patën efekt të fuqishëm. Ndryshe nga 110 qytete të tjera të Shteteve të Bashkuara në të cilat pati trazira, turma në Indianapolis u shpërnda e qetë.

Mëngjesin pas vdekjes së Kingut, Kennedy foli në Cleveland të Ohios, për “kërcënimin e pamend të dhunës”. Ai dënoi jo vetëm dhunën e plumbit apo të

bombës, por “dhunën e institucioneve; indiferencën dhe mosveprimin dhe rënien e ngadaltë”, si dhe tjetërsimin që na ndodhë teksa “i shohim vëllezërit tanë si të huaj: burra me të cilët ndajmë një qytet, por jo një komunitet; burra të lidhur për ne në ndërtesa të përbashkëta, por jo në përpjekje të përbashkëta”. Kingu kishte predikuar se ishte “i lidhur me veshjen e fatit”, ndërsa Kennedy

shtroi metaforën: “Sa herë që shqyejmë materialin e jetës të cilën një burrë tjetër e ka endur me dhembje për vete e fëmijën, tërë kombi degradon”.

Pjesa tjetër e fjalimit të Kennedyt u karakterizua nga kjo: “Ne ndoshta mund të kujtojmë, vetëm për një çast, se ata që jetojnë me ne janë vëllezërit tanë; se ata ndajnë me ne të njëjtën lëvizje të shkurtë të jetës; se ata kërkojnë, si ne, asgjë tjetër pos shans për të jetuar jetët e tyre me vendosmëri dhe lumturi... Natyrisht se kjo lidhje e besimit të përbashkët, kjo lidhje e qëllimit të përbashkët, mund të nis të na mësojë diçka. Natyrisht që mund të mësojmë të paktën t’i shohim ata që na rrethojnë si miq dhe me siguri të fillojmë të punojmë pak më shumë për të lidhur plagët midis nesh dhe për t’u bërë përsëri, në zemrat tona, vëllezër dhe bashkatdhetarë”.


Kingu punoi për të krijuar atë që ai e quajti një “komunitet të dashur”, dhe shkroi për agapen, nocionin grek të “dashurisë pa interes”. Kjo është dashuria jo për përfitim personal, por “për armikun, fqinjin nga i cili nuk mund të presësh asnjë të mirë” – një bujari kjo radikale, një “papërgjegjshmëri e rrezikshme”.

Ky angazhim ndaj atyre që janë armiqësorë ose të pakujdesshëm, të cilët nuk do ta kthejnë dashurinë tonë, mund të quhet “dashuri e vështirë”. Për Kennedyn kjo ishte jo dashuri siç përshkruhet në revistat e famshme... por “dashuria e vërtetë që është bujare dhe që përfshin sakrificën dhe dhurimin”.

Predikimi përfundimtar i Kingut, në Kishën Baptiste Ebenezer në Atlanta më 4 shkurt 1968, shpreh këtë “dashuri të vështirë”. Duke përshkruar se si do të dëshironte të falënderohej në varrimin e tij, King tha: “Dua që dikush të thotë, atë ditë, se Martin Luther King, Jr, u përpoq të donte dikë!”

Dyzet vjet më vonë, në Kishën Baptiste Ebenezer, Barack Obama nderoi trashëgiminë e Kingut. Në fillimin e fushatës së tij të parë presidenciale, Obama reflektoi epokën e të drejtave civile në Selma të Alabamas, nga ku Kingu nisi marshin e lirisë më 1965. “Jam këtu sepse dikush marshoi. Jam këtu sepse të gjithë ju sakrifikoheni për mua. Qëndrojnë në supet e gjigantëve”. Ai shtoi se qytetarët janë katalizatorë të transformimit. “Jemi ndryshimi që kërkojmë”, “jemi ata që prisim”. /Telegrafi/





**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Envert  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Maliqi: Feronikeli nuk do ta ketë problem mbijetesën

Behar Maliqi ka thënë se u rikthye në skuadrën e Feronikelit për shkak të gjendjes nëpër të cilin po kalon, kurse ka shprehur optimizëm se klubi nga Drenasi do të mbetet në Superligë. “Kemi një skuadër stabile, por për të siguruar mbijetesën dhe për të qenë më të çliruar psikikisht gjatë këtij rrugëtimi, na duhen edhe disa përforsime. Besojmë se gjithçka do të rregullohet dhe Feronikeli të qëndrojë në Superligë, pasi këtu e ka vendin”, ka thënë Maliqi

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 23 GUSHT** - Mesfushori Behar Maliqi është një prej lojtarëve më të respektuar në Kosovë. Rikthimi i tij në skuadrën e Feronikelit bëri bujë të madhe, pasi Maliqi me këtë klub ka arritur të fitojë të gjithë trofetë e mundshëm në Kosovë dhe qytetarët e Drenasit e vlerësojnë Maliqin një nga më meritoret për këto suksese. Të hënën për “Epokën e re” Behar Maliqi ka thënë se në Feronikel është rikthyer, pasi klubi po kalon nëpër një krizë të jashtëzakonshme. “Jam i lidhur ngushtë me skuadrën e Feronikelit dhe duke parë gjendjen nëpër të cilin po kalon, jam shtyrë të rikthehem dhe do të mundohem që me të gjithë potencialin t’i ndihmoj për të arritur synimet”, ka deklaruar Maliqi. Mesfushori Maliqi, duke folur për synimet e klubit në kampionatin 2021/22, ka thënë se shanset janë të mëdha që Feronikeli ta sigurojë mbijetesën. “Kemi një skuadër stabile, por për të siguruar mbijetesën dhe për të qenë më të çliruar psikikisht gjatë këtij rrugëtimi, na duhen edhe disa përforsime. Besojmë se gjithçka do të rregullohet dhe Feronikeli të qëndrojë në Superligë, pasi këtu e ka vendin”, ka thënë Maliqi. “Nikli” është skuadra e vetme që në javën e parë të Superligës nuk fitoi



pikë, sepse pësoi humbje nga Drita me rezultat 2-1. Edhe ndeshja e radhës pritet të jetë e vështirë për këtë skuadër, pasi në stadiumin “Rexhep Rexhepi” e pret skuadrën e Gjilanit. Lidhur me këtë përballje, Maliqi ka shprehur optimizëm se do të nxjerrin rezultat pozitiv. “Në secilën ndeshje në hyjmë për rezultat pozitiv. Kjo vlen edhe për ndeshjen me Gjilanin. Kundërshtari ka një skuadër të mirë, por ne do të

përgatitemi maksimalisht dhe besojmë se do t’ia arrijmë qëllimit”, ka shtuar ai. Nga Feronikeli janë larguar thujse të gjithë lojtarët kryesorë derisa në këtë klub kanë “aterruar” futbollistët Behar Maliqi, Berat Ahmeti, Dren Gashi, Alban Shabani, Azem Bejta, Lulzim Doshlaku, Qemail Elshani, Diar Prokshi, Endrit Kastrati, Granit Musa, Drilon Leku dhe Labinot Jashanica.

### SHKURT

#### KB Vëllaznimi arrin marrëveshje me trajnerin Franko Sterle

KB Vëllaznimi ka arritur marrëveshje me trajnerin Franko Sterle. Lajmi është dhënë nga klubi kuqezi na faqen zyrtare në “Facebook”. “Trajneri Sterle ka qenë për shume vjet zëvendëstrajner në BC Zadar, ekip me shumë traditë që garon në Superligën e Kroacisë. Së fundi ishte edhe trajner i KB Bashkimit. Trajneri Sterle, përveç që do të angazhohet trajner i ekipit të parë, do të angazhohet edhe në stafin e shkollës së basketbollit në klubin tonë. Ashtu siç edhe premtuam, KB Vëllaznimi do të vazhdojë përkushtimin e plotë për t’u përmirësuar në të gjitha drejtimet”, thuhet në njoftimin e skuadrës së Vëllaznimit.

#### Rashani në formacionin e javës në Ligën 1

Futbollisti i Përfaqësueses së Kosovës, Elbasan Rashani, ka shkëlqyer në javën e dytë të elitës së futbollit francez. Rashani ka kontribuar me dy gola në barazimin e Clermontit në udhëtim të Lyonit me rezultat 3-3. Ai erdhi nga banka rezervë dhe barazoi rezultat kur skuadra e tij po humbiste 3-1. Pas kësaj paraqitjeje, Rashani është përfshirë në formacionin e javës në Ligën 1. Ai u zgjodh në 11-shën më të mirë duke lënë jashtë emra të mëdhenj. Formacioni: M. Sels, S. Sow, N. Aguerd, R. Thomas, L. Paqueta, A. Herrera, I. Gueye, E. Rashani, T. Savaner, A. Delort, M. Dembele.

#### Hyseni: Golin historik ua dedikoj qytetarëve të Malishevës

Malisheva ka arritur që në ndeshjen debutuese në Superligën e Kosovës të luajë baras ndaj kampiones në fuqi, Prishtinës. Ndeshja përfundoi me rezultat 1-1, ku golin e parë historik për Malishevën e realizoi sulmuesi anësor Hasan Hyseni. Hyseni shënoi pas 13 minutave lojë, kur pas një gabimi të Kristi Vangjelit, sulmuesi kaloi edhe portierin Haxho për të shënuar. Futbollisti Hyseni golin ua dedikoi qytetarëve të Malishevës. “U angazhuan maksimalisht që t’i bëjmë ballë kampiones në fuqi. U paraqitëm jashtëzakonisht mirë, por fati nuk e desh. Është shumë e dhimbshme të pësosh në sekondat e fundit të ndeshjes. Jam shumë i lumtur që kam shënuar golin e parë për Malishevën në ndeshjen debutuese në Superligë. Këtë gol ua dedikoj të gjithë qytetarëve të Malishevës”, ka thënë Hyseni për “GazetaSheshi”. Malisheva javën e ardhshme takohet me Ulpianën.

#### Ramosaj vazhdon karrierën në Zvicër

Një prej lojtarëve kryesorë në Përfaqësuesen e Kosovës në hendboll, Bujar Ramosaj, do ta vazhdojë karrierën në Zvicër. Ramosaj ka arritur marrëveshje me skuadrën Kreuzlingen që aktualisht po qëndron në Pejë në fazën përgatitore. Kreuzlingeni garon në Ligën B të Zvicrës, ndërsa ka synime që edicionin e ardhshëm ta sigurojë kalimin në elitë. Te kjo skuadër Ramosaj bashkohet me kapitenin e Kosovës, Valon Dedaj, si dhe me Haris Berishën e Drenit Tahirukaj. Kjo katërshe e rëndësishme e Kosovës tani do të jetë së bashku edhe në klub. Ramosaj aktualisht është prej liderëve të “dardanëve”, sidomos në mbrojtje. Ramosaj në gjashtë vjetët e fundit ka luajtur për skuadrën pejane, Besa Famgas, ku është rritur shumë si hendbollist.

## Shaqiri prezantohet te Lyonit

**LYON, 23 GUSHT** - Lyonit e transferoi lojtarin shqiptar që përfaqëson Zvicrën, Xherdan Shaqiri për gjashtë milionë euro plus pesë milionë bonuse, ndërsa ka nënshkruar kontratë deri në vitin 2024. “Olympique Lyonnais është shumë i kënaqur të njoftojë nënshkrimin e mesfushorit zviceran Xherdan Shaqiri nga Liverpool, për një tarifë prej 6 milionë eurosh, me një maksimum prej 5 milionë eurosh në bonos. Shaqiri ka nënshkruar një kontratë 3-vjeçare me Olympique Lyonnais, deri më 30 qershor 2024”, thuhet në njoftimin e klubit francez.



## Xhaka: Kam nënshkruar kontratë të re

LONDËR, 23 GUSHT - Trajneri Jose Mourinho nuk do të mund të bashkohet me Granit Xhakën këtë verë. Mesfushori është kërkuar me ngulm nga trajneri portugez, por në fund në Londër kanë vendosur ta mbajnë dhe i kanë ofruar rinovimin e

kontratës. Vetë Xhaka ka arritur marrëveshjen dhe ka pranuar rinovimin deri në verën e vitit 2025. Lajmin e bën me dije vetë ai në një prononcim për faqen zyrtare të Arsenalit. Ndaj Chelseas ai mbajti për herë të parë pas shumë kohësh

shiritin e kapitenit. "Jam shumë i lumtur që jam sërish këtu. Kam nënshkruar një kontratë të re dhe dua të rikthej besimin në klub dhe te tifozët. Ata e dinë shumë mirë se unë do të jap gjithçka në çdo ndeshje dhe çdo seancë stërvitore", ka thënë Xhaka.



## Reali për Mbappen e bën sulmin final në ditën e fundit të afatit kalimtar

MADRID, 23 GUSHT - Reali i Madridit është gati që të bëjë sulmin final për të transferuar Kylian Mbappe. Lajmin e ka dhënë gazeta spanjolle "AS", e cila raporton se lëvizja e fundit e madriçenëve do të bëhet më 30 gusht, një ditë pas ndeshjes PSG-Reims, në ditën e fundit të merkatos. "Galaktikët" janë gati që të ofrojnë nga 130 deri në 170 milionë euro dhe një mal me para për sulmuesin francez i cili është në përfundim të kontratës në fundin e sezonit. Mirëpo, sheikët nuk duan të dorëzohen dhe do të bëjnë gjithçka për ta mbajtur futbollistin. Në fakt, është çështje kohe, pasi Mbappe do të jetë i Realit, maksimumi në verën e ardhshme. Strategjia e Realit është e qartë, për të punuar në fshehtësi pa i tërbuar sheikët dhe pastaj do të ofrojnë një shifër, e cila do të jetë e vështirë për t'u refuzuar. PSG-ja, gjithashtu, ka nevojë për para, por nuk dëshiron ta



humbasë futbollistin me vlerë zero në vitin e ardhshëm. Edhe vetë Mbappe nuk do që të futet në luftë totale me ekipin e tij. Nga Madridi e kanë këshilluar që të mbajë një profil të ulët në deklaratat publike, por dëshira e tij është e qartë prej muajsh: Nuk do ta rinovojë kontratën dhe kërkon të veshë fanellën e Realit të Madridit. Problemi i madh për

Florentino Perezin është që t'i bindë francezët të ulen në tavolinë, por Al Khelaifi nuk ka ndërmend ta bëjë këtë gjë. Gjatë kësaj kohe kanë qarkulluar lajme kontradiktore sepse në fillim u tha se Reali e konsideron një çështje të mbyllur dhe nuk ka ndërmend të bëjë ofertë për Mbappenë, pasi PSG-ja nuk do të pranojë asgjë dhe do ta mbajë deri në fund.

## Kloppi: Më pëlqen energjia e Haalandit, por nuk kam numrin e tij të telefonit

LIVERPOOL, 23 GUSHT - Erling Haaland admirohet nga të gjitha klubet. Ekipet e mëdha të botës e kanë pasur atë në agjendën e tyre për shumë muaj, por norvegjezi ende nuk është larguar nga Borussia Dortmundi. I fundit që ka folur për fenomenin norvegjez është Jurgen Klopp, i cili është një tjetër tifoz i futbollit të Haalandit. Liverpooli nuk ka qenë një nga klubet më të afërt me norvegjezin në muajt e fundit, por Kloppi është i vetëdijshëm se së shpejti ai do të ndryshojë ekip dhe njëkohësisht nxjerr "The Reds" nga gara për shërbimet e tij. "Herët a vonë Haaland do të ndryshojë skuadër, pasi një lojtar si ai është e pamundur që të mos të synohet nga të gjitha klubet. Nuk e di nëse do të jetë vitin e ardhshëm, por Dortmundi e di mirë që nuk do ta



ketë dhe për shumë kohë në dispozicion. Unë nuk kam numrin e tij të telefonit! Ai është thjesht një lojtar shumë interesant dhe më pëlqen energjia e tij", ka thënë Klopp. Përveç kësaj, trajneri gjerman vlerësoi vendin e tretë në Premierë Ligë sezonin e kaluar pasi, sipas tij, nuk ishte e thjeshtë të arrihej me aq shumë dëmtime sa

kishin "The Reds". "Vendi ynë i tretë ishte po aq i mirë sa titulli i vitit të kaluar. Problemi i madh ishte se duhej të luanim pa mbrojtje. Van Dijk, Matip dhe Gomez ishin jashtë dhe u desh shumë kohë që të arrinin të menaxhonin këtë situatë sepse ne kishim humbur të gjithë strukturën tonë", ka deklaruar trajneri gjerman.

### SHKURT

#### Messi debutoi në fundjavë për PSG-në

Lionel Messi mund të debutojë këtë fundjavë me PSG-në. Trajneri argjentinas, Muricio Pochettino, ka njoftuar se Messi mund t'i bashkohet skuadrës në transfertën e ardhshme në Reims. Pritet të shihet nëse Messi do të luajë ose jo teksa PSG kryeson kampionatin pas tri fitoreve në po kaq ndeshje. Parisienët e kanë nisur mirë sezonin, ndërsa të paktën në Francë pritet të mos kenë konkurrencë teksa fitojnë në fushë edhe pa Messin e Neymarin.

#### Lukaku: E kisha ëndërruar gjithmonë këtë debutim

Romelu Lukaku debutoi me gol për skuadrën e Chelseat. Kjo e fundit e mposhti në derbi Arsenalin me rezultat 2-0. Sulmuesi që u transferua te Chelsea për 115 milionë euro nga Interi, ka thënë se një debutim të tillë gjithmonë e ka ëndërruar. "Jam shumë i lumtur për këtë start. E kisha ëndërruar gjithmonë diçka të tillë. Derbi është një ndeshje e veçantë dhe të shënoja do të thotë shumë për mua. Vërshëllimat më motivojnë, në futboll ata (tifozët) janë pjesa më e bukur, por në krahu tjetër dua të falënderoj ata të Chelseat të cilët më kanë mbështetur gjatë gjithë ndeshjes. Është mirë kur kthehesh në shtëpi. Chelsea ka qenë gjithmonë shtëpia ime", ka thënë Lukaku.

#### Pas Milanit, Barça e dëshiron Silvan

Yllin e Manchester Cityt, Bernardo Silva, përveç Milanit, po e kërkon edhe skuadra e Barcelonës. 27-vjeçari e ka humbur vendin në formacionin e trajnerit Pep Guardiola, por skuadra që e dëshiron duhet të paguajë 45 milionë euro. Në anën tjetër, Manchester City synon transferimin e Hary Kanes nga Tottenham Hotspuri.

#### Kimmich deri më 2025 në Bayern

Joshua Kimmich ka vendosur të vazhdojë me Bayern Munchenin edhe për katër vjet. Kimmich ka vendosur të qëndrojë në "Allianz Arena". Ai i ishte bashkuar Bayernit nga Leipzigu në vitin 2015. Mesfushori gjerman i ka 264 paraqitje dhe 30 gola të shënuar deri më tani. Joshua Kimmich i ka fituar gjashtë Bundesliga, tri kupa të Gjermanisë dhe një Ligë të Kampionëve. Kimmich ka dhënë edhe arsyen pse ka vazhduar me "bavarezët". "Arsyeja më e rëndësishme për vazhdimin e kontratës është se këtu në Bayern mund ta shijoj pasionin tim çdo ditë. E kam një ekip me të cilin mund të arrij gjithçka dhe kam shumë bashkëlojtarë të cilët i kam bërë miq të vërtetë".

## Allegri sqarohet pse Ronaldo nuk ishte titullar

Juventusit barazoi të dielën ndaj Udineses me rezultat 2-2, por ajo që bëri shumë jehonë ishte lënia e Cristiano Ronaldos në bankën rezervë. Portugezi u inkuadrua në lojë në pjesën e dytë dhe shënoi gol, i cili nuk u pranua për shkak të pozitës jashtë lojës. Trajneri

Massimiliano Allegri ka thënë se nuk e la Ronaldon në bankë për zgjedhje taktike, por është çështje forme në fillim të sezonit. "Ronaldo është mirë. Kisha folur me të dhe duke parë fazën përgatitore që kemi bërë të gjithë deri tani, i thashë se do të na bënte më shumë punë, në

pjesën e nxehtë të takimit. Ai u vu menjëherë në dispozicion dhe shënoi edhe gol, por nëse nuk ia quajmë të mirë për 3-4 milimetra, kjo është gjë tjetër... I thashë: 'Eja me mua në stol, pasi duhet ta përmirësojmë formën'. Nuk ishte një zgjedhje teknike, as ndonjë nga ato

gjërat e tjera që do të shkruani ju. Është, thjesht, çështje forme dhe në fillim të sezonit për t'i kuptuar disa situata, në mënyrë që të kemi vazhdimësi. Ishte zgjedhja ime për ta lënë Ronaldon në stol. Nuk ma kërkoi as ai dhe askush tjetër", ka thënë Ronaldo.

Tre vjet pa ty Nënë e dashur!




# **Arife (Morina) Krasniqi**

(01.09.1949 - 24.08.2018)

Edhe pse je në atë botë, ne këtu ndiejmë mall, mall që kurrë nuk do të shuhet. Pusho e qetë Nënë, se ne nuk do të harrojmë kurrë. Vdekja jote është mungesë e pazëvendësueshme, dhembje e pashëruar. Malli për ty do të mbetet gjithmonë pjesë e jetës sonë. Vlera jote është e madhe. Atë e dimë vetëm Ne që mbetëm pa ty.

*Më mall të pashuar të kujtojnë: Djemt, vajzat, rejat, nipat dhe mbesat nga Tërpeza e Malishevës, Gjermani, Suedia, Franca e Prishtina.*



**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

RESTAURANT

**SWISS**

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook [www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## &gt;&gt; SHPALLJE TË VOGLA &lt;&lt;

Gentiana Maloku Shoshi, me numër personal 1003483041 shpall të pavlefshme Licencën e Specialistes së Pediatriisë me numër KO -05259-01-12 të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës

► Mergim Asani shpall të pavlefshme dëftesat e kl. së dhjetë, njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë si dhe diplomën e shkollës së mesme "7 Shtatori" Prishtinë.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokalit është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokalit gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



## PASHTETË PULE

**MEKA**  
HALAL FOOD

gluten  
free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues